



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 400/01-7741 dt. 27/02/ 2026



Bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit. Nenit 90, pika 1 të Ligjit Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera, si dhe Rregullores (QRK) Nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera. Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.02.2026 miratoi këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Raportit përfundimtar të Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera

Neni 1

Me këtë Vendim, në përputhje me nenin 31, paragrafi 1.1 të Rregullores (QRK) Nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera, propozohet miratimi i Raportit përfundimtar të Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera.

Neni 2

Me miratimin e këtij Vendimi nga Kuvendi i Komunës, konfirmohet vlerësimi i dëmeve në shumën totale prej 1,595,901.15 €, të ndara si në vijim: 400,253.15 € për dëme në ekonomi familjare; 1,062,106.50 € për dëme në biznese; 86,402.50 € për dëme në bujqësi; 47,139.00 € për dëme në automjete.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi përgjegjës janë: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, si dhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit
- Palës



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Barim Bujupi

ARSYETIM

Raporti përfundimtar i Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera është hartuar në përputhje me Ligjin Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera dhe me Rregulloren (QRK) Nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera.

Në bazë të këtyre akteve normative, komunat obligohen të themelojnë komisione për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Përmes këtij komisioni është realizuar procesi i vlerësimit me qëllim të përcaktimit të llojit dhe madhësisë së dëmit në të mira materiale, të shprehura në vlerë monetare, e nevojshme për rikthimin e tyre në gjendjen paraprake, përkatësisht për blerjen ose riparimin e tyre.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Kryetari i Komunës, pas dhënies së pajtimit të tij, obligohet ta dorëzojë raportin në Kuvendin Komunal për shqyrtim dhe miratim. Pas miratimit nga Kuvendi, raporti dorëzohet brenda afatit prej 15 ditësh në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, si dhe një kopje i përcillet Komisionit Qendror për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera, i cili bën vlerësimin e korrektësisë së tij dhe evidenton mangësitë eventuale.

Duke marrë parasysh sa më sipër, si dhe rekomandimet e Komisionit Qendror lidhur me procedurën e shqyrtimit të raporteve të komunave për vlerësimin e dëmeve në të mirat materiale dhe ndikimin e fatkeqësive të tjera, propozohet që, brenda afatit ligjor dhe në përputhje me nenin 31, paragrafi 1.1 të Rregullores (QRK) Nr.17/2015, të miratohet ky Propozim-Vendim.